




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA


KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Datë/A:	14.01.2024
Për/Za/To:	Bashkim Ramosaj- Kryetar i Komunës
Nga/From/Od : Përmes:	Ajne Iberhysaj- Zyrtare për Barazi Gjinore 
Tema/Subject/Subjekt	Raporti për periudhën Janar- Dhjetor - 2024

Zyra e Kryetarit, gjegjësisht Zyra për Barazi Gjinore gjatë periudhës janar-dhjetor ka qenë e përkushtuar për avancimin e barazisë gjinore, ka qenë e fokusuar në disa komponentë, ndër të tjera veçojmë: Harmonizimi i akteve normative komunale me Ligjin për Barazi Gjinore dhe ligjet tjera në funksion të barazisë gjinore, siç është; Rregullorja për ngarkesa, taksa dhe gjoba, Rregullorja për ndarjen e bursave për studentë, si në vijim:

- Është hartuar dhe miratuar Strategjia Komunale Për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2024-2027 dhe Plani i Veprimit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje 2024-2027
- Janë mbajtur tri takime të Mekanizmit Komunal kundër Dhunës në Familje dhe janë hartuar procesverbale të takimeve, të cilat janë publikuar në ueb faqen komunale.
- U mbajt Debati Publik për Draft-Strategjinë Komunale Kundër Dhunës në Familje (2024 – 2027).
- Botimi i broshurës informuese, e cila përmban infrastrukturën ligjore që rregullon dhe përmirëson nivelin e sigurisë dhe efikasitetin për parandalimin, trajtimin dhe ri-integrimin e rasteve të dhunës në familje.
- Ndriçimi me ngjyrë portokalli dhe vendosja e “Kordelës së Bardhë” në faqen zyrtare të komunës dhe në faqen zyrtare të kryetarit të komunës.
- Për fuqizimin ekonomik të grave janë ndërmarrë masa adekuate, ku komuna në bashkëpunim me donatorë ka bërë subvencionimin shoqatave të grave që merren me kultivimin e kulturave të ndryshme bujqësore si dhe produkteve ushqimore, artizanale etj.

	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E DEÇANIT - OPSTINA DEÇAN
Miratuar nga: A. Iberhysaj	1245
02	14.01.25

- Janë mbajtur takime nga këshillimorja në kuadër të Drejtorisë së Bujqësisë e cila rregullisht gjatë vitit 2024 ka mbajtur trajnime me fermer, kryesisht fermerë femra për krijimin e bizneseve të reja në agrikulturë, kultivimin e perimeve kultivues dhe trajnime tjera në zhvillimin e bujqësisë që rrisin fuqizimin ekonomik posaçërisht të grave.
- Gjithashtu, drejtorja për bujqësi për pylltari dhe zhvillimi rural ka nda subvencione për gratë; rritjen e kapaciteteve të serave dhe pajisje bujqësore në bashkëpunim me donatorë.
- Në bashkëpunim me USAID-in është duke u realizuar për të drejtat pronësore të grave, në kuadër të këtij projekti janë organizuar fushata për vetëdijësimin të qytetarëve për të drejtat pronësore të grave, janë organizuar tryeza me akteret përgjegjës, është promovuar Udhëzimi Administrativ për regjistrimin e pronës së paluajtshme në emër të dy bashkëshortëve, etj
- Janë mbajtur ligjërata në shkollat për dhunën në familje, kundër trafikimit me qenie njerëzore si dhe keqpërdorimin e rrjeteve sociale, ku nga këto ligjërata kanë përfituar nxënës të shkollave të komunës sonë.
- Për vitin 2024 nga Drejtorja për Buxhet dhe Financa është bërë rimodelimi i KAB-it nga perspektiva gjinore, të planifikimit të buxhetimit tre- vjeçar nga perspektiva gjinore.
- Komuna e Deçanit, GLV “Gjeravica” si dhe Ministria e Bujqësisë, është hartuar Strategji afatmesme zhvillimore lokale 2024-2028, në të cilën janë përcaktuar prioritetet strategjike për zhvillimin e bujqësisë, projekteve investive kapitale në bujqësi, subvencionimi i fermerëve, krijimi i bizneseve të reja në primëkulture, etj.
- Janë mbajtur aktivitete për 16 dhiteshin kundër dhunës në familje nga data 26 nëntor deri me 10 Dhjetor , dukuri kjo që është mjaftë e prezentë në shoqërinë tonë dhe ka marrë përmasa të gjëra, sipas raportit të stacionit të policisë për rastet e raportuara për vitin 2024 janë 39 raste kurse sipas Gjykatës Themelore në Pejë dega në Deçan raste për shkurorëzim janë 40.
- Duke u bazuar në objektivat e strategjisë kundër dhunës në familje janë paraparë aktivitete vetëdijësuese për parandalim- fushata sensibilizuese, duke hartuar politika të reja publike, që kanë për synim parandalimin e dhunës, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave të dhunës. Ndërsa sa i përket riintegrimin të viktimave të dhunës në familje, Komuna e Deçanit ka lidhur Marrëveshje Mirëkuptimi me Qendrën e Strehimit në Pejë, për financimin e kësaj qendre për çdo vit, por në rast të rritjes së numrit të strehimit të viktimave në këtë qendër, veç shumës së paraparë në marrëveshje, buxheti komunal ndahet shtesë në proporcion me viktimat e strehuara.

- Veç kësaj, Komuna e Deçanit, ka punësuar 4 psikologë, politikë kjo që e bënë më të lehtë identifikimin e dhunës në familje, pasi që dhuna ndikon indirekt edhe tek fëmijët në familje, pasi që fëmijët e përjetojnë më së rëndi dhunën në familje, dhe identifikimi i tyre mund të bëhet më lehtë nga psikologët shkollor.
- Komuna e Deçanit, çdoherë do të jetë e përkushtuar në hartimin e politikave të reja publike për çështjet e barazisë gjinore, duke u fokusuar në të gjitha fushat që prekin këtë çështje.

AKTIVITETE TE REALIZUARA PËR BARAZI GJINORE PËR VITIN 2024

ZYRTARËT KOMUNAL PËR BARAZI GJINORE NDOQEN TRAJNIMIN “BARAZIA GJINORE ONLINE: TRENDET E SOTME DHE STRATEGJITË INOVATIVE PËR NDRYSHIM”

Qendra e Trajnimit të AKK-së organizoi trajnim dy ditor me temën “Barazia Gjinore Online: Trendet e Sotme dhe Strategjitë Inovative për Ndryshim”.

Ky trajnim kishte për qëllim pajisjen e Zyrtarëve Komunal për Barazi Gjinore me njohuri dhe aftësi të domosdoshme për të përdorur rrjetet sociale si mjet i fuqishëm në ndërgjegjësimin dhe promovimin e barazisë gjinore si dhe për të nxitur pjesëmarrje aktive për ndryshim pozitiv nëpër komunat e Kosovës,

Gjatë këtyre dy ditëve intensive, u diskutuan trendet dhe strategjitë inovative për të promovuar një kulturë të barazisë gjinore përmes mediave sociale. Qendra e Trajnimit është e përkushtuar të vazhdojë këtë angazhim me Zyrtarët për Barazi Gjinore që t’i pajisë ata në përdorimin e çdo platformë dhe burimi në dispozicion për të ngritur dhe avancuar zërin e barazisë gjinore.

[#asociacionikomunave](#) [#qendraetrajnimit](#) [#barazigjinore](#) [#HeForShe](#)





Fuqizimi i gruas

Tryezë e rumbullaket me temën : Fuqizimi i gruas duke zvogëluar dallimet në rajonin e Pejës, organizuar nga OSBE me datë 20 mars ne Peje ne hotel Dukagjini. Kjo tryezë e rumbullaket e cila ka për qëllim të përforcoj komunikimin dhe bashkërendimin mes zyrtareve për barazi gjinore dhe kryesueseve të grupeve të grave në rajonin e Pejës. Tryeza ka për qëllim të ndihmoj në shkëmbimin e të arriturave dhe njohurive mes zyrtareve për barazi gjinore dhe grupeve të grave, duke paraqitur momentin e duhur dhe dialogun e parë mbi barazinë gjinore dhe gratë në qeverisje të nivelit ekzekutiv dhe legjislativ në rajonin e Pejës.



Manifestimi i Ditës së gruas “8 Marsi” në Deçan

Me këngë, valle, dokumentar e bashkëbisedim, është festuar “8 Marsi” në Deçan, gjithashtu është shfaqur edhe dokumentari “Gruaja Dukagjinase dje dhe sot”- frymëzim për të gjitha gratë! I organizuar nga znj. Shkendije Berisha Pacolli, me komunën e Deçanit! Festa e 8 Marsit, me kohë ka marrur simbolikën e sakrificës dhe dashurisë së gruas shqiptare për familjen, shoqërinë dhe kombin. Në këtë ditë, uroj për të gjitha nënat, motrat, grat e vajzat, që çdo ditë e juaja të jetë e mbushur me respekt, vlerësim dhe dashuri, sepse përkushtimi që ju falni në jetë dhe në punë, bënë që roli juaj në shoqëri të jetë i pazëvendësueshëm.



Me këngë, valle, dokumentar e bashkëbisedim, sot është festuar “8 Marsi” në Deçan.
“Gruaja Dukagjinase dhe sot”- frymëzim për të gjitha gratë! Falënderim të veçantë për znj.
Shkendije Berisha Pacolli, për organizimin e këtij eventi!



Punëtorja me temën “Dhuna në familje dhe Mekanizmi Komunal kundër Dhunës në Familje”

2024/04/30 - 10:28



Punëtorja me temën “Dhuna në familje dhe Mekanizmi Komunal kundër Dhunës në Familje”, u organizua nga Ekipi Monitorues Ndërlidhës të KFOR-it (LMT), me OSBE-në, mbështetur nga Kryetari i Komunës, z. Bashkim Ramsoaj. Punëtorja u mbajt me nxënësit e shkollës së mesme “Vëllezërit Frashëri” për ngritjen e vetëdijes kundër dhunës në familje, dhuna ndaj grave dhe dhuna me bazë gjinore. Parandalimi i këtij realiteti të trishtë është e domosdoshme të mbahen punëtori edhe në shkollat e tjera, meqë rastet e dhunës në familje në vitet e fundit vetëm sa janë shtuar dhe jo e kundërta. Në këtë punëtori morën pjesë anëtarët e mekanizmit, Xhavit Nimonaj-Udhëheqës i

Njësisë kundër Dhunës në Familje në Stacionin e Policisë, Ardita Ramizi –Bala, Drejtoreshë e Strehimores në Pejë, Ibrahim Lushaj-Zyrtar në Qendrën për Punë Sociale, Besnik Hulaj- Drejtor për Arsim, Hamid Qorraj- Drejtori i Gjimnazit “Vëllezërit Frashëri”, si dhe nxënës të gjimnazit. Anëtarët e mekanizmit komunal, KFOR-i, OSBE-ja, drejtori i gjimnazit ndanë informacione me nxënësit në lidhje me dhunën në familje dhe i ftuan nxënësit që të përhapin mesazhin rreth temës dhe mënyrës së raportimit të rasteve të mundshme të dhunës në familje.



Klubi i Hendbollit për Vajza “Jusuf Gërvalla”,



Ankthi dhe Depresioni (Postpartum)

Mbështetur nga Komuna e Deçanit, është organizuar tribuna me Prof. Dr. Ferid Aganin me temën: Ankthi dhe Depresioni (Postpartum). Të pranishmit i njoftoj rreth ankthit dhe pasojat që mund t'i sjellë shoqërisë, i cili duhet të trajtohet që nga shfaqja e shenjave të para dhe konstatohet me profesionist përkatës. Me moton “Thyje heshtjen, nuk je vetëm” ! <https://fb.watch/sw6z22xley/>



Organizimi i Ditës për fëmijë “Një Qershori”

Komuna e Deçanit është e përkushtuar për mbrojtjen e fëmijëve, por edhe për krijimin e kushteve për zhvillimin dhe edukimin e tyre në mjedis të shëndoshë e të sigurve



Diskutim mbi buxhetimin gjinor në Komunën e Deçanit

Drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj. Dafina Cacaj, së bashku me z. Visar Gjakova, Menaxher i Programit, dhe znj. Elena Morina, Asistente e Programit nga Instituti Kombëtar Demokratik (NDI), dhe Ekspertja për Buxhetim Gjinor, znj. Elirjeta Beka nga Rrjeti i Grupit të Grave të Kosovës, mbajtën një diskutim në tryezë të rrumbullakët mbi Buxhetimin Gjinor në Komunën e Deçanit.

Në këtë tryezë u diskutua për Buxhetimin e Përgjegjshëm Gjinor në komunën e Deçanit, i cili është një qasje proaktive që synon të sigurojë që alokimet dhe shpenzimet buxhetore adresojnë nevojat dhe prioritetet specifike të grave, burrave, vajzave dhe djemve në mënyrë të barabartë. Kjo strategji pranon se buxhetet nuk janë neutrale ndaj gjinisë dhe se ato ose mund të përjetësojnë ose të zbusin pabarazitë gjinore brenda shoqërisë. Duke përfshirë perspektivën gjinore në proceset buxhetore,

Deçani po punon drejt ndërtimit të një shoqërie më të barabartë dhe gjithëpërfshirëse, ku nevojat dhe të drejtat e të gjithë banorëve njihen dhe adresohen plotësisht.

Ky program është mbështetur nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).



Promovimi i Barazisë Gjinore përmes teknologjisë Informative të Avancuar”

Me iniciativë të Zyrtareve për Barazi Gjinore në nivelin lokal, dhe nën organizimin e Agjencisë për Barazi Gjinore u mbajt trajnimi me temë “Promovimi i Barazisë Gjinore përmes teknologjisë Informative të Avancuar” dhe moren pjesë 19 ZBGJ

Ky trajnim kishte si qëllim forcimin e kapaciteteve të ZBGJ në përdorimin e teknologjisë së avancuar digjitale, ndikimin e teknologjisë dhe sigurisë kibernetike në aspektin gjinor, rendësin e përdorimit të inteligjencës artificiale në hartimin e politikave gjinore etj.

Trajnimi u mbështet me asistencë teknike nga [UN Women Kosovo](#)



Muaji Rozë në Deçan: Ndërgjegjësimi për kancerin e gjirit

Kryetari i Komunës, z. Bashkim Ramosaj sot beri hapjen e fushatës për ndërgjegjësimin e kancerit të gjirit, në një takim informues me gratë e Komunës së Deçanit dhe vizitë në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare.

Kjo fushatë ka për qëllim ndërgjegjësimin e grave për parandalimin, trajtimin dhe kujdesin që duhet treguar për këtë sëmundje. Aktivitete të tjera do të mbahen gjatë gjithë muajit.

Inkurajojm të gjitha gratë që të bëjnë kontrole të vazhdueshme pasi që zbulimi i hershëm është mbijetesë.





Muaji Rozë në Deçan: Ndërgjegjësimi për kancerin e gjirit

Zyra për Barazi Gjinore, në bashkëpunim me Drejtorinë për Shëndetësi, organizoi një takim informues në Komunë dhe në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare, në kuadër të fushatës për ndërgjegjësimin e kancerit të gjirit.

Gjatë takimit, Kryetari i Komunës, z. Bashkim Ramosaj, theksoi rëndësinë e rritjes së ndërgjegjësimit dhe inkurajimit të grave për të kryer kontrole të rregullta, që janë vendimtare për parandalimin dhe zbulimin e hershëm të kancerit të gjirit.

Drejtoresha për Shëndetësi, znj. Agnesa Vokshi, nënvizoi se kujdesi për shëndetin është hapi i parë drejt një jete më të shëndetshme dhe të lumtur, duke shtuar se çdo kontroll ka potencialin të bëjë një ndryshim të madh. Mesazhi i fushatës është i qartë: parandalimi është çelësi i shpëtimit dhe vetëm së bashku mund të arrihet një ndikim i vërtetë në luftën kundër kësaj sëmundjeje.

Debati Publik për Draft-Strategjinë Komunale Kundër Dhunës në Familje (2024 – 2027).

Debatin Publik e udhëhoqi, z. Ajne Iberhysaj, ky dokument strategjik, u hartuar në bashkëpunim me institucione relevante, paraqet një hap të rëndësishëm drejt parandalimit të dhunës dhe përmirësimit të mirëqenies së qytetarëve në komunën tonë. Qëllimet e Strategjisë përfshijnë:

- Parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në familje.
- Forcimin e mekanizmave koordinues për adresimin e dhunës në baza gjinore.
- Draft-Strategjinë Komunale Kundër Dhunës në Familje (2024 – 2027), u hartuar nga:
- Grupi i punës për hartimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit.
- Drejtoritë komunale përkatëse.
- Mekanizmi Koordinues Kundër Dhunës në Familje.

Strategjia mbështetet në:

- Ligjin Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale.
- Ligjin Nr.08/L-185 për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Baza Gjinore.
- Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave 2022-2026.
- Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr.07/2018 për planifikimin dhe hartimin e dokumenteve strategjike dhe planeve të veprimit.

Foto: Debati për Strategjinë Komunale Kundër Dhunës në Familje (2024 – 2027)

